

## Ndërmjetësimi i normalizimit: SHBA dhe BE në (jo)veprim

### Hyrje

Më 15 prill 2020, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse (CIG) përmes një telekonference mbledhi një grup ekspertësh kosovarë dhe serbë për të vlerësuar përpjekjet e fundit të SHBA-ve dhe BE-së për rifillimin e dialogut midis Serbisë dhe Kosovës, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse. Që nga vjeshta e vitit 2019 dhe para shpërthimit të COVID-19, i dërguari special i Presidentit të SHB-ve për negociatat e paqes mes serbëve dhe kosovarëve, Richard Grenell ka bërë një përpjekje të fuqishme që të dy palët të nënshkruajnë tri "letra qëllimi" për krijimin e linjës ajrore, autostradës dhe poashtu linjës hekurudhore direkte midis Kosovës dhe Serbisë. BE qëndroi mjaft e tërhequr gjatë vitit 2019. I emëruar në fund të vitit 2019, si Përfaqësues i Lartë i BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, Josep Borrell vizitoi Prishtinën dhe Beogradin në fillim të vitit 2020. Në prill të vitit 2020, për të mbështetur punën e tij, Këshilli Evropian emëroi ish-Ministrin e Jashtëm Sllovak Miroslav Lajčak si Përfaqësues Special të BE-së për Dialogun Beograd-Prishtinë, si dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor.

Në mes të pandemisë COVID-19 dhe pas rritjes së presionit nga SHBA-të mbi Kosovën për të hequr tarifën 100% ndaj mallrave serbe, qeveria e udhëhequr nga Kryeministri Albin Kurti reagoi me hapa të ngadaltë duke zëvendësuar tarifën me reciprocitet, dhe duke shkaktuar kështu mosmarrëveshje të brendshme brenda koalicionit qeverisës, si dhe rënjen eventuale të qeverisë. Kjo shkaktoi një diskutim të gjerë mbi rolin e SHBA-ve dhe lidhshmërinë midis rënies së qeverisë dhe mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare midis Serbisë dhe Kosovës para zgjedhjeve presidenciale në SHBA. Hiperaktiviteti i SHBA-ve dhe plogështia e dukshme e BE-së shkaktojnë shqetësime në lidhje me natyrën e marrëveshjes së mundshme, qëllimin e saj, zbatimin eventual dhe rezultatet e pasojave të mundshme. Përballja me shqetësime të tilla varet nga BE-ja, akteri kryesor që mund të sigurojë stabilitetin afatgjatë në Ballkanin Perëndimor. Prandaj, pyetja më e rëndësishme është se çfarë mund të bëjë BE-ja për të ushtruar ndikimin e saj dhe për të rimarrë udhëheqjen e saj të dialogut.

Punëtorja është pjesë e një iniciative më të madhe të CIG lidhur me marrëdhëniet Kosovë-Serbi, mbështetur dhe implementuar në bashkëpunim me Departamentin Federal të Zvicrrës për Punë të Jashtme.

## Angazhimi i SHBA-ve dhe perspektivat për një marrëveshje përfundimtare

Rënia e qeverisë në Kosovë çoi në një vakuum të pushtetit, dhe tani për tani është e paqartë nëse qeveria e re, e udhëhequr me gjasë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), së bashku me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), NISMA, dhe partitë e pakicave, do të formohet ose do të ketë zgjedhje të reja, me siguri pas pandemisë. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, po bën presion të madh që të formohet qeveria e re. Disa pjesëmarrës thanë që nëse Thaçi e mandaton një kandidat nga një parti tjetër, Lëvizja Vetëvendosje (VV) do ta dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, e cila, sic thane shumica e ekspertëve, me shumë mundësi do të ishte në përputhje me pritjet e presidentit. Për herë të parë në Kosovë, bashkësia ndërkombëtare duket se po anon nga njëri drejtim. Vendet e BE-së mbështesin Kurtin, ndërsa i dërguari amerikan Grenell favorizon Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe "gardën e vjetër" të LDK-së. Kurti dhe VV duan zgjedhje sepse mendojnë se kjo situatë sugjeron ekuilibrin në favor të tyre dhe do të garantojë një fitore mbi 50 përqind të votave. Sidoqoftë, palët e tjera janë të vetëdijshme për këtë dhe do të rrinë së bashku për të mos lejuar që kjo të ndodhë. Prandaj, nëse qeveria formohet pa zgjedhje dhe me një mbështetje të heshtur nga PDK, shumica do të ketë dy të tretat në Kuvend për të ratifikuar ndonjë marrëveshje përfundimtare. PDK ka të ngjarë që nuk do ta mbështesë zyrtarisht qeverinë e re por do të jetë e domosdoshme për mbijetesën e saj. Prandaj, votat e Listës Serbe janë të domosdoshme për të arritur një shumicë të thjeshtë. Shumica presin që Lista Serbe të ndjekë urdhrat e Presidentit serb Aleksandar Vuçiq, i cili tani duket se është në përputhje me qëllimet e Thaçit dhe Grenell.

Angazhimi energjik i SHBA-ve për heqjen e tarifës dhe presionin që rezulton mbi qeverinë e Kosovës janë të lidhura me zgjedhjet e ardhshme presidenciale në nëntor, thanë disa prej ekspertëve të pranishëm në telekonferencë, si një përpjekje për të ofruar një lloj fitore të politikës së jashtme që mund të ndihmojë në forcimin e imazhit të presidentit amerikan Donald Trump në vend. Sidoqoftë, disa folës ishin skeptik se ky është objektivi, duke argumentuar se ky do të ishte një qëllim mjaft i parëndësishëm i politikës së jashtme për një votues amerikan. Disa pjesëmarrës theksuan se këto përpjekje mund të lidhen edhe me ambiciet dhe qëllimet personale të Ambasadorit Grenell. Megjithatë, shumë njerëz shprehën dyshim se një marrëveshje është gati, dhe se do të ishte e mundur të nënshkruhej dokumenti përpara fundit të këtij viti. Duke marrë parasysh pandeminë COVID-19 dhe zgjedhjet e ardhshme në Serbi, disa pjesëmarrës arritën në përfundimin se ky vit është i humbur për një marrëveshje përfundimtare paqeje mes Kosovës dhe Serbisë. Disa madje shprehën mendimin se asgjë nuk do të ndodhë para zgjedhjeve në SHBA. Shumica e pjesëmarrësve thanë se administrata aktuale e SHBA nuk është e interesuar të adresojë interesat e Serbisë ose Kosovës. "Amerikanët tani po veprojnë kryesisht për arsye personale."

Disa pjesëmarrës thanë se Vuçiq me siguri i ka aprovuar planet e Grenell, dhe kjo është arsyeja pse ka presion vetëm mbi Prishtinën. Sidoqoftë, është e paqartë se cilat janë qëllimet e vërteta të Vuçiqit. Disa pjesëmarrës mendojnë se aktualisht Beogradi po ikën nga çështja e Kosovës. Për Beogradin më e rëndësishmja është që negociatat të zgjasin sa më gjatë. Të tjerë thanë se fakti që Grenell nuk është i përqendruar në presionin e Serbisë nuk do të thotë se ekziston një *carte blanche* (liri për të vepruar si të dojë) nga Beogradi për marrëveshjen. Pyetja është se çfarë

përmban marrëveshja. Pozicioni i Vuçiqit është më i brishtë në të djathtë të spektrit politik, dhe nacionalistët në Serbi janë të gatshëm të reagojnë nëse ai bën lëvizje radikale. Sidoqoftë, kjo është koha ideale për Beogradin, pasi që për herë të parë Beogradi ka krijuar komunikime miqësore me Uashingtonin, dhe çdo administratë tjetër amerikane do të kishte shumë më shumë kërkesa ndaj Beogradit.

Kjo çon në pyetjen e natyrës së marrëveshjes. Disa thanë që ekzistojnë dy mundësi: a) një dokument kozmetik dhe i paqartë, i ngjashëm me tri "letrat e qëllimit", diçka si "Marrëveshja për Paqen", dhe b) një marrëveshje shumë më thelbësore dhe më radikale që do të përfshinte shkëmbimin e territoreve. Opsioni i parë do t'i shërbente vetëm qëllimeve të marrëdhënieve publike të administratës amerikane, ndërsa i dyti do të krijonte pasoja shumë më serioze. Me shumë mundësi, kjo do të provokonte një mosmiratim serioz të brendshëm në Kosovë që Kurti si drejtuesi i partisë më të madhe do të ishte në gjendje të instrumentalizonte, të rrëzonte qeverinë e re dhe të kthehej në pushtet. Kështu, disa pjesëmarrës sugjeruan me forcë që çdo marrëveshje të gëzojë mbështetjen më të gjerë të mundshme publike në Kosovë dhe Serbi. Dhe në atë situatë, BE-ja dhe SHBA-të duhet të ofrojnë shërbime të mira.

## **Cilat janë opsionet për BE-në?**

Dialogu i udhëhequr nga BE-ja nuk ka qenë kurrë në një pikë më të keqe se tani, përfunduan pjesëmarrësit. BE-ja, me pasivitetin e saj, mungesën e iniciativave dhe ndoshta me zgjedhjen e personaliteteve, ka zvogëluar pozicionin e saj. Emërimet e fundit në Bruksel në lidhje me dialogun nuk u pritën mirë në Prishtinë. Të dy Borrell dhe Lajcak vijnë nga vendet anëtare të BE-së që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Kështu që nëse BE-ja dëshiron të përfshihet dhe të ketë më shumë ndikim dhe veçanërisht të udhëheqë procesin e ardhshëm, ekziston nevoja për një shtytje serioze si nga BE ashtu edhe nga vendet anëtare për të rimarrë ndikimin politik. Në çdo rrethanë, nëse ekziston një marrëveshje potenciale, BE-ja dhe vendet anëtare do të jenë ato që kujdesen për zbatimin dhe çdo pasojë që mund të shfaqet.

Pjesëmarrësit sugjeruan një numër masash dhe hapash të mundshëm që BE mund të ndërmarrë për të rivendosur besueshmërinë e saj dhe për të rifituar epërsinë në proces. Lista bazohet në diskutimet e punëtorive.

- BE duhet të deklarojë me vendosmëri se Kosova është një problem evropian. BE është përgjegjëse për stabilitetin afatgjatë në rajon;
- Brukseli duhet të refuzojë një marrëveshje të shpejtë pasi një marrëveshje përmbajtësore serioze nuk mund të nxitohet;
- BE dhe vendet anëtare duhet të mbështesin forcat politike të Kosovës të luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar;
- BE duhet të përshpejtojë përpjekjet për zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit, pasi që kjo është një nga kushtet kryesore për rikthimin e besueshmërisë së BE;
- BE duhet të zhvillojë një mekanizëm sanksionesh për palët e përfshira në proces. Administrata amerikane përdor kërcënime për sanksione por BE është ajo që ka mallra të vërteta për të sanksionuar, pasi është partneri kryesor për secilën palë. Sidoqoftë, disa paralajmëruan se me sanksione BE-ja mund ta largojë rajonin edhe më shumë;
- BE duhet të lehtësojë masat e përbashkëta Kosovë-Serbi në luftën kundër COVID-19;

- Një nga kushtet kryesore është ofrimi i liberalizimit të vizave në Kosovë. Pa të, besueshmëria e BE-së në Kosovë do të vazhdojë të vuajë;
- Brukseli duhet të qëndrojë konsistent ndaj mesazheve të dërguara në Beograd, Prishtinë dhe Bruksel. Në të kaluarën e fundit, përfaqësuesit e BE-së po përcillnin mesazhe të ndryshme në vende të ndryshme;
- BE duhet të marrë drejtimin mbi çështjet e ekonomisë dhe shëndetit pasi ato do të jenë çështjet më të rëndësishme për qytetarët e Kosovës dhe Serbisë pas krizës COVID-19.

## **Participants**

**Belul Beqaj**

**Shpetim Gashi**

**Ismet Hajdari**

**Vincent Hug**

**Agon Maliqi**

**Milivoje Mihajlovic**

**Petar Miletic**

**Branislav Nesovic**

**Igor Novakovic**

**Zoran Ostojic**

**Lulzim Peci**

**Dejan Radenkovic**

**Alex Roinishvili Grigorev**

**Nexhmedin Spahiu**

**Stefan Surlic**